



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 20.2.2025

Nr: 120

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR PERIUdhËN 09 SHKURT-15 SHKURT 2025**

Sot, më datë 20.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

**SUBJEKT:** Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 09 shkurt-15 shkurt 2025, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. “Inspektim në repartet Ushtarake Korçë, Mjekës, Mirakë”, raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 13.02.2025.
2. Mbyllja e Kursit “Stërvitje individuale Bazë”, raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025.

Data: 20.2.2025 Nr: 120  
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025”

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: *“Për sa i përket aktiviteteve të raportuara është bërë një ngatërrese në data e raportimit, ku përkatësisht: Inspektim në repartet Ushtarake Korçë, Mjekës, Mirakë, raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 13.02.2025, duhet të ishte data e zhvillimit 16.02.2025; dhe “Mbyllja e Kursit “Stërvitje individuale Bazë”, raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025 duhet të ishte data e zhvillimit 17.02.2025”.*

Referuar pretendimeve të dhëna dhe hetimeve të kryera nga ana e KQZ, vlerësohet se është kryer një gabim gjatë hedhjes së të dhënave në ndërfaqe. Në këto kushte, mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**